



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**GENDER AND
THE JUDICIARY**
in the Western Balkans



Trajnim online për barazinë gjinore



 **UK Government**

Zbatimi i këtij projekti mbështetet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Trajnimi për barazinë gjinore

Qendra AIRE ka krijuar një trajnim online për barazinë gjinore për profesionistët/et gjyqësorë/e me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Ky trajnim online është në dispozicion për gjyqtarët/et, zyrtarët/et policorë/e, punonjësit/et socialë/e, studentët/et e juridikut, profesionistët/et në media dhe të gjithë individët e tjerë të interesuar.

Trajnimi është në dispozicion në të gjitha gjuhët që fliten në Ballkanin Perëndimor.

Qëllimet e trajnimit

- ▶ Promovimi i barazisë gjinore përmes familjarizimit të pjesëmarrësve/eve me konceptet kryesore të barazisë gjinore, siç janë përkufizimi dhe qartësimi i koncepteve të roleve gjinore, identiteteve gjinore dhe orientimit seksual, si dhe bërja e dallimit mes tyre.
- ▶ Luftimi i njëanshmërisë dhe stereotipeve gjinore që manifestohen haptaz në sallat e gjyqit në tërë Ballkanin Perëndimor, si dhe vetëdijësimi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore dhe rolin e gjyqësorit në promovimin e saj.
- ▶ Mundësimi i të kuptuarit më të thellë të konceptit të barazisë gjinore dhe i arsyeve përse barazia gjinore është çështje e rëndësishme, si zbatohet ky parim në praktikë dhe cilat janë efektet e tij.
- ▶ Dallimi mes koncepteve të diskriminimit, ngacmimit seksual dhe ngacmimit në vendin e punës.

Regjistrimi

- ▶ Ju mund të regjistroheni në uebfaqen e Qendrës AIRE: <https://edu.airewb.org/>, ku do të krijoni profilin tuaj në platformë.

Përmbajtja e trajnimit

- ▶ Trajnimi përmban tre modulet e mëposhtme:

Moduli I, i cili shpjegon arsyet përse jemi përqendruar në barazinë gjinore, do të mundësojë që pjesëmarrësit të kuptojnë:

- ▶ konceptin e barazisë gjinore;
- ▶ konceptet e seksit dhe gjinisë, dhe dallimet mes tyre;
- ▶ konceptet e roleve gjinore, identiteteve gjinore dhe orientimit seksual, si dhe dallimet mes tyre.

Moduli II, i cili përqendrohet tek njëanshmëritë dhe stereotipet gjinore si shkaktarë të diskriminimit, do të mundësojë që pjesëmarrësit:

- ▶ të kuptojnë konceptet e njëanshmërisë dhe stereotipeve, si dhe njëanshmërinë dhe stereotipet gjinore;
- ▶ të njohin njëanshmërinë dhe stereotipet gjinore si shkaktarë të diskriminimit;
- ▶ të kuptojnë konceptin dhe llojet e diskriminimit dhe specifikat e tyre, me fokus të veçantë tek diskriminimi kundër grave.

Moduli III, i cili trajton çështjen e dhunës kundër grave, do të mundësojë që pjesëmarrësit:

- ▶ të kuptojnë konceptin e dhunës kundër grave si dhunë me bazë gjinore;
- ▶ të njohin paraqitjen dhe format e ndryshme të dhunës kundër grave;
- ▶ të kuptojnë shkallën e dhunës kundër grave në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Pjesëmarrësve u ofrohen materiale të tjera referuese dhe prezantime që shtjellojnë me hollësi temat e moduleve, si dhe teste pas çdo moduli.

Kohëzgjatja

- ▶ Trajnimi online nuk kërkon përgatitje paraprake ose shtesë. Ju keni **120 minuta** kohë në dispozicion për të shfrytëzuar në mënyrë aktive materialet që ju nevojiten.
- ▶ Gjithashtu, ju duhen edhe rreth **60 minuta** (varësisht nga njohuritë e mëparshme) për të mësuar kurrikulën dhe për të zhvilluar testet.
- ▶ Për çdo pjesëmarrës/e që e përfundon trajnimin lëshohet një **certifikatë**. Pikët e dhëna nga Qendra e Trajnimit Gjyqësor dhe Prokurorial për të gjithë/a profesionistët/et që e përfundojnë trajnimin do të llogariten pikë të vlefshme për karrierën e tyre.



Qendra AIRE

Qendra AIRE (*Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë*) është një organizatë e specializuar jo-qeveritare që promovon zbatimin e të drejtës evropiane dhe ndërkombëtare. Ka njëzet vjet që Qendra AIRE ka krijuar reputacion të pakrahasueshëm në Ballkanin Perëndimor, duke vepruar në të gjitha nivelet e sistemeve të drejtësisë në rajon. Ajo punon në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e drejtësisë, me qendrat e kualifikimit gjyqësor, si dhe me gjyqtarë/e dhe prokurorë/e për të udhëhequr, ndihmuar dhe mbështetur reformat e përqendruara në fuqizimin e shtetit të së drejtës dhe luftimin e korrupsionit. Njëkohësisht, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e OJQ-ve në tërë rajonin drejt forcimit të reformave ligjore dhe respektimit të të drejtave themelore.